



Komiteti për shëndetësi dhe përkujdesje sociale

PROCESVERBAL

Mbledhja e Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale është mbajtur me datë **27.12.2023 (e mërkurë)** me fillim në ora **08:10**.

Mbledhjen e shtatë e kryesoi Kryesuesja znj. **Vlora Vuçiterna Çmega**.

Për këtë mbledhje, u propozua ky rend dite;

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e anëtarëve të Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale;
3. Vizitë në AMF-në, në lagjen e komuniteteve;
4. Vizitë në AMF-në, në lagjen e epërme në Rahovec;
5. Vizitë Këshillit të Pacientëve në Rahovec.

Kryesuesja – Atëherë fillimisht përshëndetje për të gjithë. Pas leximit të rendit të ditës, po e vendosim në votim si të tillë. Kush është “pro”?... Me vota unanime miratohet rendi i ditës.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesja – A ka dikush ndonjë gjë rreth procesverbalit?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është “pro”?... Me shumicë unanime aprovohet pika e parë.

2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e anëtarëve të Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale;

Lirigzon Kastrati – Faleminderit kryesuese! Sot është mbledhja e fundit e vitit, ne e kemi dhënë kontributin tonë gjatë këtij viti kalendarit, mirëpo është mirë që viti 2024 të fillohet më mirë me vizita të ndryshme nëpër AMF, duke filluar prej Oterushës dhe Drenocit. Një tjetër gjë të rëndësishme që duhet ta praktikojmë janë takimet me OJQ të ndryshme që ofrojnë shërbime sociale dhe me akterë tjerë shëndetësorë.


3. Vizitë në AMF-në, në lagjen e komuniteteve;

4. Vizitë në AMF-në, në lagjen e epërme në Rahovec;

5. Vizitë Këshillit të Pacientëve në Rahovec;

Kryesuesja – Atëherë tri pikat e fundit kanë të bëjnë me vizitat tona në terren që do t'i bëjmë pas mbledhjes. Nëse dikush nuk ka ndonjë gjë tjetër, faleminderit për sot dhe shihemi në mbledhjen e radhës.

Procesmbajtësi;


Albion Krasniqi



Kryesuesja e mbledhjes;


Vlora Vuçiterna - Çmega